



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 lidhur me nenin 14, paragrafi 1, dhe 3, te Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019”, e konform nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 6 paragrafi 3 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2025, miraton këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

**JEPET PËLQIMI**-për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës si më poshtë;

1. **Parcela** kadastrale, **P-72116038-00313-21**, sipas certifikatës Nr. 147/2025, të datës 13.01.2025, zona kadastrale Samadrexhë, vendi i quajtur “Ledina Vogël”, me sipërfaqe prej: **7084m<sup>2</sup>**, e evidentuar pasuri në emër të Komunës së Suharekës, me destinim sipas Hartës zonale të Komunës (HZK) zonë “Agro-industriale” në Samadrexhë, për ushtrimin e aktivitetit afarist-bujqësor **“Kultivimi i perimeve në sera”**,
2. **Parcela** kadastrale, **P-72116038-00313-22**, sipas certifikatës Nr. 147/2025, të datës 13.01.2025, zona kadastrale Samadrexhë vendi i quajtur “Ledina Vogël”, me sipërfaqe prej: **6556m<sup>2</sup>** e evidentuar pasuri në emër të Komunës së Suharekës, me destinim sipas Hartës zonale të Komunës (HZK), zonë “Agro-industriale” në Samadrexhë, për ushtrimin e aktivitetit afarist-bujqësor **“Kultivimi i perimeve në sera”**,

### Neni 2

**OBLIGOHET**-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër, Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019” dhe Rregurores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr- 016-7448  
Më datë 30-01-2025



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. G. Bexhet KUÇI